



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.545/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Bujar Muzaqi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.02.2025, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, Anr.545/2025 e datës 10.02.2025, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë.

### A r s y e t i m

Me datë 10.02.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.545/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në të cilën pretendohet se kandidati Mustaf Abazi, nga radhët e subjektit politik LDK, më 9 shkurt 2025 në ora 7:00 e tutje me postimin e tij të sponsorizuar, në llogarinë e tij në rrjetin social Facebook, ka thyer heshtjen zgjedhore. Me tutje në ankesë theksohet se me këtë veprim kandidati dhe subjekti politik LDK, kanë bërë fushatë zgjedhore duke shfrytëzuar rrjete sociale, edhe pse heshtja zgjedhore ka filluar me hapjen e qendrave të votimit për votim përkatësisht në orën 07:00. Andaj me këtë veprim kanë bërë shkelje të nenit 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, si dhe nenit 8, paragrafi 1.5 të Rregullores Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Si provë ka bashkangjitur CD që dëshmojnë shkeljet e tilla të bërë në ditën e zgjedhjeve.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik LDK, theksohet se ankesa e tillë është e pabazë për faktin se kandidati Mustaf Abazi me kohe i ka ndaluar sponzorizimet e tij në rrjetin social Facebook, andaj pretendimet e ankuesit se kandidati në fjalë ka shkelur nenin 37 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të LZP-se dhe nenin 8 paragrafi 1.5 të Rregullores Zgjedhore 07/2024 të KQZ-se nuk qëndrojnë fare, një gjë të tillë e dëshmojnë edhe me fotografit e bashkangjitura si provë në përgjigje në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga subjekti politik LDK, vlerësoj se pretendimet e parashtruara në ankesë janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj si të pa bazuara, kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së bërë nga ana e kandidatit të subjektit politik LDK z. Mustaf Abazi, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë si dhe nga verifikimet e bëra vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që një postim i tillë nuk është aktiv në rrjetin social Facebook, dhe se nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar, dhe koha e saktë e postimit.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi të pabazuara.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.545/2025 më datë 13.02.2025



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.